



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2023:269521

Datë: 27.03.2024

Numri i dokumentit: 05509857

**C.nr.4698/2023**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – Departamenti i përgjithshëm, divizioni civil**, gjyqtari Taulant Rexhëbeqaj, në çështje juridike kontestimore të paditësit B.S. me numër personal ..... nga Prizreni, kundër të paditurës Sh.S.K.U.K. – Spitali Rajonal - Prizren, për shkak të kompensimit të pagave të 13-ta, jashtë seancës, me datë 27.03.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**HEDHET** poshtë si e palejuar, padia e paditësit B.S. nga Prizreni, kundër të paditurës Sh.S.K.U.K. – Spitali Rajonal - Prizren, për shkak të kompensimit të pagave të 13-ta, padia pasi që është paraqitur nga personi i pa autorizuar.

A r s y e t i m

Pranë kësaj gjykate, av. S.K. nga Prishtina, më datë 01.12.2023, ka paraqitur padi me paditës B.S. nga Prizreni, kundër të paditurës Sh.S.K.U.K. – Spitali Rajonal - Prizren, për shkak të kompensimit të pagave të 13-ta.

Padisë së iniciuar nuk i'u është bashkangjitur autorizimi i përfaqësuesit të paditësit, për këtë arsye, gjykata në Aktvendimin e datës 27.02.2024, në kuptim të dispozitës së nenit 93.2 të LPK-së, e fton paditësin me qëllim që t'ia dorëzoj gjykatës parashtresën e kërkuar- autorizimin në afat prej 3 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi, në pikën II të këtij aktvendimi është njoftuar për pasojat në rast të mos veprimi sipas këtij aktvendimi.

Meqë gjykata nuk ka mundësi të veprojë sipas padis së paditësit për shkak se paditësi brenda afatit të caktuar nga gjykata nuk ka paraqitur, për Shoqëria e Avokatëve: Studio Ligjore & Financiare “Klinaku ....” me avokatët e saj: S.K. etj., nga Prishtina, Në mbështetje të Sh.S.K.U.K. – Spitali Rajonal - Prizren, për shkak të kompensimit të pagave të 13-ta nenit 93.3 të LPK-së ku thuhet se “...Në qoftë se ky afat kalon pa sukses, gjykata do t'i anulojë veprimet procedurale të kryera nga personi pa prokurë...” dhe nenit 390 të LPK-së parashihet që “Nëse gjykata konstaton se padia është e pakuptueshme apo jo e plotë, apo se ekzistojnë mungesa që kanë të bëjnë me zotësinë e paditësit apo të paditurit që të bëhet palë ndërgjyqëse, apo me përfaqësimin ligjor të tyre, apo mungesa që i përkasin autorizimit të përfaqësuesit që ta inicioj procedurën kontestimore, kur autorizimi i tillë kërkohet me ligj, gjykata me qëllim të

Numri i lëndës: 2023:269521  
Datë: 27.03.2024  
Numri i dokumentit: 05509857

*heqjes së mungesave të tilla i ndërmerr masat e nevojshme të përcaktuara me këtë ligj (neni 79 dhe 102 i këtij ligji)*”.

Gjykata konstaton se padia e paraqitur nga Shoqëria e Avokatëve: Studio Ligjore & Financiare “Klinaku .....” me avokatët e saj: S.K. etj, është inicuar nga personi i pa autorizuar dhe i njëjti në afatin e caktuar nga gjykata nuk ka prezantuar autorizimin e palës paditëse, ndërsa që në shkresat e kësaj lënde nuk ekzistojnë provat që i njëjti të ketë vepruar konform këtij vendimi. Mbi këto rrethana gjykata gjeti se janë plotësuar kushtet për të vepruar në kuptim të nenit 93.3 të LPK-së, për të anuluar të gjitha veprimet e ndërmarra në këtë procedurë dhe rrjedhimisht për të hedhur poshtë padinë si veprim i parë i ndërmarrë procedural.

Në bazë lartcekurave në kuptim të nenit 102.3 lidhur me neni 93.3 dhe 390 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN,  
Departamenti i Përgjithshëm  
C.nr.4698/2023, datë 27.03.2024**

**Gjyqtari,**

**Taulant Rexhëbeqaj**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit Gjykatës së Apelit përmes kësaj gjykate.